



Lidership

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Lidership

Përmbajtja

Lidership;

|

- ▶ Zhvillimi i teorisë së lidershipit;
- ▶ Natyra e lidershipit
- ▶ Lidership vs.Menaxhimi
- ▶ Lidershipi si Proces



Lidership;

Zhvillimi i teorisë së lidershipit; Natyra e lidershipit

Lidership vs. Menaxhimi

Lidershipi si proces

Lidershipi

Për analizë të procesit të lidershipit është me rëndësi të analizohet lidershipi si raport në mes liderit dhe pasuesve/vartësve.

Tom Peters dhe Nansi Ostin në librin „**Pasioni për përsosje**„ (1995) ofrojnë një përkufizim pak si poetik të lidershipit më të cilin edhe reflektohet më së miri natyra komplekse e lidershipit:

Lidershipi nënkupton vizion, anim, ngazëllim, dashuri, besim, vrull, pasion, opsion, konsistencë, përdorim të simboleve, kujdes për detajet, krijim të heronjve në çdo nivel, mentorim, bredhje efektive rreth e rrotull dhe shumë gjëra tjera... Lidershipi duhet të jetë prezent në çdo nivel të organizatës. Varret nga miliona gjëra të cilët bëhen me obsesion, konsistencë dhe kujdes, por këto gjëra nuk do kenë asnjë vlerë nëse mungon besimi në vete, vizioni dhe besimi i të tjerëve.

Lidershipi

- ▶ lidershipi nuk është proces linear dhe një-kahesh por është një fenomen interaktiv. Kur lidershipi definohet në këtë formë pozita e liderit është e kapshme për të gjithë jo vetëm për liderin formal në grup.
- ▶ Lidershipi nënkupton ndikim dhe prandaj është me rëndësi të vlerësohet mënyra se si lideri ndikon tek pasuesit/vartësit
- ▶ Me lidership nënkuptohet edhe drejtimi në realizimin e qëllimeve.
- ▶ Lidershipi „paraqet proces me të cilin individi ndikon tek grupi i individëve në arritjen e qëllimit të përbashkët. Bernard Bass



Lidershipi

- ▶ Shumica e dijetarëve të lidershipit në shekullin XX e perceptonin lidershipin si tërësi e tipareve (trait approach) dhe ky model paraqet bazamentin e hulumtimit shkencor mbi lidershipin.
- ▶ Në fillim të shekullit XX janë hulumtuar karakteristikat që e bëjnë një individ lider të madh. Në këtë kontekst, janë zhvilluar teoritë “**mbi njeriun e madh**” të cilët janë orvatur t’i identifikojnë cilësitë dhe karakteristikat e lindura të liderëve të mëdhenj politik, shoqëror dhe ushtarak (Gandi, Abram Lincoln, Napoleon Bonaparta etj.).



Lidershipi

- ▶ Nga mesi i shekullit XX, teoria e lidershipit si tërësi e tipareve vihet në pyetje me hulumtimet që kishin të bëjnë me karakteristikat universale të liderit.
- ▶ Stogdill (1948), thekson se nuk ekziston tërësi konzistente e tipareve në bazë të cilave mund të diferencohet lideri nga jo-lideri.
- ▶ **Një person që ka karakteristikat e liderit mund të jetë lider në një kontekst kohor dhe hapësinor por në kontekstin tjetër nuk do të zgjidhet si lider, prandaj**
- ▶ sipas Stogdill ***lidershipi përkufizohet si interaksion në mes njerëzve në situata të ndryshme shoqërore.***



Tipareve kyçe të lidërshepit

Sipas Stogdil, nga hulumtimi I dÿte I tij, tiparet janë në korrelacion pozitiv me lidërshepin. Ky autor identifikon 10 tipareve kyçe të lidërshepit:

1. Marrje e përgjegjësisë dhe dedikim në realizimin e detyrave,
2. Realizim të qëllimeve me përkushtim të lartë,
3. Guxim në ndërmarrjen e riskut dhe origjinalitet në zgjedhjen e problemeve,
4. Nevojë për realizimin e iniciativave në shoqëri,
5. Vetëbesim dhe identitet të ndërtuar personal,

Tiparet kyçe të leadershipit

vazhdim

Sipas Stogdil, nga hulumtimi I dyte I tij, tiparet janë në korrelacion pozitiv me leadershipin. Ky autor identifikon 10 tipareve kyçe të leadershipit:

6. Gatishmëri që të pranohen konsekuencat për vendimet dhe veprimet,
7. Gatishmëri për zgjedhjen e problemeve ndër-njerëzore,
8. Vullnet që të tolerohen zhgënjimet dhe vonesat,
9. Aftësi të ndikohet në sjelljen e individëve dhe
10. Kapacitet të strukturoren raportet sociale konform qëllimit që ka lideri.

Studimet mbi tiparet dhe karakteristikat e liderit

Stogdill (1948)	Mann (1959)	Stogdill (1974)
<ul style="list-style-type: none">• Inteligjenca• Vigjilenca• Mendjemprehtësia• Përgjegjësia• Këmbëngulësia• Vetëbesimi• Socializimi (i shoqërueshëm)	<ul style="list-style-type: none">• Inteligjenca• Burrëria• Dominimi• Ekstravert• Konservator	<ul style="list-style-type: none">• Arritja• Qëndrueshmëria• Mendjemprehtësi a• Iniciativa• Vetëbesimi• Përgjegjësia• Kooperimi• Toleranca• Ndikimi• Socializimi (I Shoqërueshëm)

Studimet mbi tiparet dhe karakteristikat e liderit

11

Lord, Devader
dhe Alliger
(1986)

- Inteligjenca
- Burrëria
- Dominimi

Kirkpatrick
dhe Locke
(1991)

- Energjetik
- Motivimi
- Integriteti
- Besueshmëria
- Shkathtësia kognitive
- Njohja e detyrave

Zaccaro,
Kemp & Bader (2004)

- Kapaciteti kognitiv,
- Ekstravert,
- Stabilitet emocional
- I vetëdijshëm,
- I hapur
- I kuptueshëm
- I motivuar
- Inteligjenca sociale
- Vet-motivimi
- Inteligjenca emocionale
- Zgjedhja e problemeve

Tiparet dhe karakteristikat e liderit

Disa nga karakteristikat bazike që dalin në pah në më tepër studime janë:

- ▶ Inteligjenca
- ▶ Vetëbesimi
- ▶ Vendosmëria
- ▶ Integriteti
- ▶ Socializimi



Koncepte të rëndësishme për Liderhipin e bazuar në tipare

- ▶ Dija- informatë që ndryshon diçka apo personin duke u përdor si bazë për ndryshime apo duke ngritur kapacitetin e personit apo institucionit për të ndërmarrë veprime efektive - Peter F. Drucker in The New Realities
- ▶ Shkathtësia- ekspertizë që zhvillohet me anë trajnimeve apo eksperiencës, përfshin zeje, shkathtësi gjatë punës praktike

Koncepte të rëndësishme për Liderhipin e bazuar në tipare

- ▶ Besimi - premisa apo gjykime të cilat personi i perception si të vërteta
- ▶ Vlera - ide mbi vlerën e gjërave, koncepteve dhe njerëzve. Vlerat burojnë nga besimi i personit. Vlerat janë pjesë përbërëse e qëndrimeve.

Lidership vs. Menaxhimi

- ▶ Në dekadat e fundit zhvillohet një debat intensiv mbi raportet në mes lidershipit dhe menaxhmentit.
- ▶ Lidershipi në shumë çka është i ngjashëm më menaxhimin.

Por këto dy koncepte nuk janë identike

- ▶ Lidershipi mësohet qysh nga koha e Aristotelit ndërsa shkenca e menaxhmentit është dukuri e dy shekujve të fundit me paraqitjen e shoqërive të industrializuara (revolucioni industrial).
- ▶ Menaxhmenti u paraqit si rezultat i orvatjeve për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të organizatave.



Lidership vs. Menaxhimi

Kotter (1990) krahasoi funksionin e menaxhmentit dhe funksionin e lidershipit.

- ▶ Funksioni bazë i menaxhmentit është të siguroj konsistencë dhe rend në organizatë ndërsa funksioni i liderit është të nxisë ndryshime dhe lëvizje të organizatës.



Menaxhmenti Krijon rregulla dhe konsistencë	Lidershipi Nxit ndryshime dhe lëvizje organizatës
Planifikim dhe buxhetim <ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i agjendës • Përcaktimi i orarit të aktiviteteve • Shpërndarja e resurseve 	Drejtim <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i vizionit • Ofrimi i një pasqyre më të gjerë për realitetin • Përcaktimi i strategjisë
Organizimi dhe punësimi <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i strukturës • Hapja e vendeve të punës • Përcaktimi i rregullave dhe procedurave 	Shpërndarja e resurseve <ul style="list-style-type: none"> • Drejtim në realizimin e qëllimeve • Kërkim të devotshmërisë • Ndërtim të ekipeve dhe koalicioneve
Kontrolli dhe zgjedhja e problemeve <ul style="list-style-type: none"> • Inkurajimi i punonjësve • Zgjedhja kreative e problemeve • Ndërmarrja e veprimeve kolektive 	Motivim dhe inspirim <ul style="list-style-type: none"> • Inspirim dhe energji • Dhënia e autorizimeve tek vartësit • Përmbushja e nevojave të vartësve

Lidership vs. Menaxhimi

- ▶ Bennis dhe Nanus vlerësojnë se menaxhmenti nënkupton realizim të aktiviteteve dhe rutinë ndërsa lidershipi nënkupton ndikim tek tjerët dhe krijim të vizionit të ndryshimeve, sipas tyre: “menaxherët janë ata që e bëjnë punën në mënyrën e duhur ndërsa liderët janë ata të cilët e bëjnë punën e duhur”.
- ▶ Sipas Rost (1991), lidershipi është ndikim i dyanshëm ndërsa menaxhmenti është raport i njëanshëm i autoritetit. Lidershipi përqendrohet në procesin e realizimit të qëllimeve të përbashkëta ndërsa menaxhmenti në bashkërenditjen e aktiviteteve për realizimin e punëve.



Lidership vs. Menaxhimi

- ▶ Menaxhmenti merret me ruajtjen e rendit dhe stabilitetit ndërsa lidershipi me kërkimin e ndryshimeve konstruktive.
- ▶ Edhe pse aktivitetet e menaxhmentit dhe lidershipit dallohen nuk mund të ketë zhvillim të organizatës, nëse organizata nuk ka menaxhment dhe lidership të mirë.
- ▶ Që të kemi organizata të suksesshme duhet të kemi menaxhment me ekspertizën e duhur dhe lider me aftësitë e duhura.

Lidershipi si proces

- ▶ Lidershipi ndërmarrës nuk është një pozitë, por është një proces.
- ▶ Lidershipi perceptohet si proces për realizimin e ndikimit i cili i ndihmon një grupi të arrij qëllimet e përbashkëta.
- ▶ Lideri ndërmarrës merr përgjegjësinë për të ndihmuar ndërmarrjen në krijimin e kushteve të tilla në mënyrë që, në vend të jetë e kontrolluar, ndërmarrja gjeneron rendin e vet dhe i përgjigjet në mënyrë kreative mjedisit. Ky rol nuk është vetëm më produktive për ndërmarrjen, ajo është çliruese për liderin gjithashtu. Duke ndihmuar të lejojnë potencialin kreativ të ndërmarrjeve të tyre, lideret ndërmarrës qesin në pah kreativitetin e tyre.

Lidershipi vs. menaxhimi- konkluzion

- ▶ Edhe pse ekzistojnë dallime në mes menaxhmentit dhe lidershipit këto dy sfera në segmente të ndryshme përplasen. Kështu, kur menaxherët ndikojnë në grupin për realizimin e qëllimeve të përcaktuara ato janë të kyçur në procesin e lidershipit, në njëjtën kohë kur lideret inkuadrohen në planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin në fakt kyçen në procesin e menaxhmentit. Të dyja proceset ndikojnë në grupin me qëllim që të realizohen qëllimet.
- ▶ Lidershipi merret me raportet ndër-personale duke instaluar shpirtin e duhur në organizatë/komunitet.



Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu

butrint.batalli@universitetiaab.com